



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Bashkia Lezhë, Lagjia Skënderbeg, Sheshi "Gjergj Kastrioti", 4501, Lezhë, e-mail: f.frokaj@lezha.gov.al, www.lezha.gov.al

VENDIM

Nr 187 Datë 28/10/2016

Për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi mes Komunave Piana degli Albanesi, Castellamare del Golfo, Custonaci, Alcamo, në Palermo, Itali dhe Bashkive të Lezhës, Krujës dhe Rrogozhinës në Shqipëri.

Mbështetur ne Ligjin 139/2015, datë 17.12.2015, " PËR VETËQEVERISJEN VENDORE", Neni 9, "Të drejtat dhe përgjegjësitë", pika 1.5. "Të drejtën e bashkëpunimit", paragrafi b) "bashkëpunojnë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;" si dhe në Vendimin Nr. 734, datë 9.9.2015, "PËR RREGULLIMIN E VEPRIMTARISË ME JASHTË TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE" pikat 9 dhe 11c,

VENDOSI:

- 1- Të pranojë bashkëpunimin shumëpalësh ndërmjet Komunave Piana degli Albanesi, Castellamare del Golfo, Custonaci, Alcamo, në Palermo, Itali dhe Bashkive të Lezhës, Krujës dhe Rrogozhinës, dhe të hartojë një marrëveshje partneriteti me këtë qëllim.
- 2- Të ngarkojë me këtë detyrë Kryetarin e Bashkisë Lezhë.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit.

KRYETARI

Gjok Ndoka

SEKRETARI

Jerina Vataj

